

Udhëzime

Faturat e ujit:

- Nëse ju duhet që të paguani faturën e ujit, bëni veprimet direkt tek “Cashier” [arkëtari].
- Jepini cashier [arkëtarit] faturën tuaj të ujit ose kërkoni që të printojë një faturë për ju.
- “Amount Due” [pagesa që duhet bërë] gjendet në mes të faturës.
- Ju mund të paguani për faturën tuaj të ujit me çek, me para në dorë ose me urdhër-pagese.
- Mbasi të paguani, arkëtari do t’ju japë një kundra-faturë me vulën “E paguar” që ta mbani në ruajtje.
- Nëqoftese ju është shkëputur uji, arkëtari mund të marrë në telefon për ta rilidhur. Një pagesë shërbimi prej 20 dollarësh duhet bërë për të gjitha ato fatura për të cilat është e nevojshme të bëhet rilidhja me ujin e ndërprerë. Për rastet e ndërprerjes së ujit, shërbimi duhet të rifillojë në ora shtatë, të të njëjtës mbrëmje.

Pasuria personale/Taksa mbi pasurinë e paluajtëshme:

- Shkoni tek sporteli dhe kërkoni ndihmë nënpunësit.

Për pasurinë personale

- I thoni nënpunësit nëse keni ndonjë problem me makinën tuaj, me makinën e marrë me qera apo me biznesin.
- Ju duhet ti jepni nënpunësit faturën tuaj, numrin e sigurimeve shoqërore, ose emrin.
- Nëqoftëse nuk jeni i regjistruar ose nëqoftëse ju duhet një dokument për makinën me qera.do t’u dergojnë tek

Assessor's Office [Zyra e vlerësimit të pasurive] në dhomën 114.

- Nëse ju duhet një kopje e faturës, nënpunësi mund t'ju bëjë një kopje të saj për 1 dollar.
- Cashier [arkëtari] do të marrë pagesën dhe do t'u kthejë faturën e vulosur.

Për pasurinë e paluajtëshme

- Ju duhet që ti jepni nënpunësit faturën tuaj, adresën, ose emrin mbi të cilin është prona.
- Nënpunësi do të kontrollojë nëse ka ndonjë shkelje me taksat dhe do të shtypë një faturë të re (nëse duhet), dhe pastaj do t'ju drejtojë tek arkëtari.
- Ka plot mënyra për të paguar taksat, si p.sh.: në zyrë duke paguar me para në dorë, me çek, me urdhër pagese, ose duke përdorur kartën e kreditit apo të debitit (aplikohen pagesat minimum për shërbimet). Konsumatorët mund të paguajnë edhe me internet në adresën: officialpayments.com; me telefon: 1-800-2PAY-TAX; ose në një nga zyrat tona.
- Fatura që është më e hershme duhet paguar e para.
- Pagesat e pjesëshme pranohen vetëm për pasuritë e paluajtëshme.
- Pasuritë që janë në çështje gjyqësore duhet ti paguajnë të gjitha vitet si edhe pagesat e gjyqit në një dorë.